

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 17.02.2020 (dymije e njezete), u redaktua kontrata e shitjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Bennet Holding" Sh.p.k person juridik shqiptar rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS L82405013A dhe seli me adrese Njesia Bashkiake nr.7, Rruga "Dritan Hoxha", Nd.11, H.3, Ap.32. Tirane me personat e identifikuar si ne vijim:

SHITESI:

- Znj. Veronica Bernardini shtetase italiane, lindur me 24.05.1993 ne Siena dhe banuese ne Via Della Repubblica,162 Poggibonsi(SI) mbajtese e dokumentit te identifikimit leternjoftim me numer CA36510AH, leshuar me dt.07.08.2017 dhe e vlefshme deri me 24.05.2028, madhore me zotësi te plote juridike dhe për të vepruar, ortak i vetem i 1(nje) kuote ne masen 100 % te kapitalit ne vleren 100,000 leke e cilesuar ne vijim si "Shitesi";

BLERESI:

- Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino shtetas italian, lindur me 06.07.1991 ne Catania CT dhe banues ne adresen "Via Dell Ionio,1 ACI Catena CT, Itali mbajtes i dokumentit te identifikimit leternjoftim me numer CA41624FX, leshuar me dt 23.01.2020 dhe e vlefshme deri me 06.07.2030, madhor me zotësi te plote juridike dhe për të vepruar,i cilesuar ne vijim si "**Bleresi**"
- Z. Andrea Giuseppe Ardita shtetas italian, lindur me 22.04.1990 ne Catania CT dhe banues ne adresen "Via Chiusa Della Corte 1" ACI Catena CT, Itali mbajtes i dokumentit te identifikimit pasaporte me numer YA4632593, leshuar me dt.13.06.2013 e vlefshme deri me 12.06.2023, madhor me zotësi te plote juridike dhe për të vepruar,i cilesuar ne vijim si "**Bleresi**"

Ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar si dhe me Vendimin bashkelidhur te Ortakut te Vetem te Shoqerise, per shitjen e kuotave te Shoqerise, palet deshirojne te lidhin kete kontrate.



Neni 1

Objekti kontratës

Znj. Veronica Bernardini vendos te shesë 40% te pjeses zoteruese te kapitalit te shoqerise qe zotëron ne shoqërine "Bennet Holding" Sh.p.k, Blerësit si ne vijim:

-Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino, i cili pranon te bleje 20% te pjeses zoteruese te kapitalit te shoqerise qe shitesi Znj. Veronica Bernardini zoteron ne shoqërine "Bennet Holding" Sh.p.k.

- Z. Andrea Giuseppe Ardita, i cili pranon te bleje 20% te pjeses zoteruese te kapitalit te shoqerise qe shitesi Znj. Veronica Bernardini zoteron ne shoqërine "Bennet Holding" Sh.p.k..

Neni 2

Çmimi dhe pagesa

Çmimi i caktuar për shitjen e kuotave te shoqërisë është vlerësuar ne baze te vleres se kapitalit themelor, i cili eshte 100.000,00 leke si pasoje shitësi shet kuotat blerësve si vijon:

Znj. Veronica Bernardini, i shet kuotat ne masën 40% te kapitalit me vlere 40.000 leke, perkatesisht Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino 20% te pjeses zoteruese te kapitalit ne vleren 20,000 leke dhe Z. Andrea Giuseppe Ardita 20% te pjeses zoteruese te kapitalit ne vleren 20,000 leke.

Palët deklarojnë qe pagesa eshte bere cash duke mos patur me pretendime si dhe garantojne reciprokisht njera tjetren se cmimi i shitjes se kuotave eshte i drejte dhe i arsyeshem dhe i caktuar me vullnetin e lire dhe te plote te paleve.

Palët caktojnë me marrëveshje dhe pranojnë qe Shitësi do te derdhe për llogari te tatimeve, ne baze te parashikimeve ligjore perkatëse te tatimit ne burim per fitimin e realizuar nga shitja e kuotave.

Neni 3

Pronësia dhe transferimi i kuotave

3.1 Pala shitëse i garanton palës blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj te treteve dhe për çdo pretendim qe mund te ngrëne te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palëve blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbrojtur te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.



3.2 Pronësia e kuotave i transferohet blerësve ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate shitblerje.

Bleresit pranojne pronesine e kuotave, duke njohur gjendjen e shoqerise dhe bien dakort me te gjitha te drejttat dhe detyrimet e lindura nga zoterimi i kuotave brenda shoqerise, sipas percaktimeve te statutit te shoqerise dhe ligjit shqiptar.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate,

- **Shitesi Znj. Veronica Bernardini themelues i shoqerise "Bennet Holding" shpk do të zotërojë 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 60.000 (gjashtëdhjetmijë) lekë e barabartë me 60% të vlerës së kapitalit të regjistruar.**
- **Blerësi Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino behet zoterues i 1(nje) kuote të kapitalit me vlerë 20.000 (njëzetmijë) lekë e barabartë me 20% të vlerës së kapitalit të regjistruar.**
- **Blerësi Z. Andrea Giuseppe Ardita behet zoterues i 1(nje) kuote të kapitalit me vlerë 20.000 (njëzetmijë) lekë e barabartë me 20% të vlerës së kapitalit të regjistruar.**

U perkthye nga Italishtja ne Shqip nga Znj Theodhora Llupa

PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITESE

Znj. Veronica Bernardini

Veronica Bernardini
Veronica Bernardini

PALA BLERESE

Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino

Daniilo Salvatore Simone Adamantino
Daniilo Salvatore Simone Adamantino

Z. Andrea Giuseppe Ardita

Andrea Giuseppe Ardita
Andrea Giuseppe Ardita